

1.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË LIPJANIT PËR VITIN 2025

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, maj 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Lipjanit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Lipjanit (KL), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Lipjanit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Ishin bërë keqklasifikime të shpenzimeve në kategoritë ekonomike të ndryshme në vlerë 2,222,992€, përfshirë pagesa për paga jubilarë, shujta, mallra dhe shërbime që janë raportuar në kategori të gabuara ekonomike.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Lipjanit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Pagesë prej 7,000€ në kundërshtim me kontratën për shpenzimet e energjisë elektrike të stadiumit 'Sami Kelmendi'."
- B2 Në shtatë (7) mostra me vlerë të përgjithshme 9,119€, kemi vërejtur se faturat ishin vonuar për pagesë, përtej afatit ligjor prej 30 ditësh për pagesën e obligimeve.
- B3 Mangësi në bazën e të dhënave të tatimpaguesve në pronë.
- B4 Në tri (3) raste Komuna nuk kishte bërë monitorim të subvencioneve dhe pranimi e serrave nga komisioni ishte bërë pas përfundimit të kontratës.
- A2 Pranimi i mallrave në kundërshtim me rregulloren e pasurisë.
- A3 Mangësi në menaxhimin e pasurisë jo financiare kapitale dhe jo kapitale.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i Komunës së Lipjanit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunës së Lipjanit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunës së Lipjanit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Lipjanit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Lipjanit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Lipjanit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Lipjanit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Lipjanit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të dukshme, rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: klasifikim i drejtë i shpenzimeve, mangësi në prokurim, dobësi në menaxhimin me të hyra, mos raportim i përfituesit për subvencionin e marr, mbivlerësim të pasurive, menaxhim jo të mirë të kontratave, vonesa në pagesën e faturave, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 12 rekomandime, prej tyre katër (4) janë rekomandime të reja, shtatë (7) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2025, ishin realizuar pagesa nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarimore në vlerë 2,387,613€. Sipas regjistrit të komunës borxhi kryesor ishte 1,708,393€, ndërsa 679,220€, ishin shpenzime të interesit dhe shpenzime tjera procedurale të gjykatës/përmbarimit.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore nr. 08/L-332 neni 15 paragrafi 12 thekson se ndarjet buxhetore nga rezerva me prioritet ndahen në kategorinë përkatëse të shpenzimeve për shlyerjen e vendimeve përmbartimore dhe gjyqësore me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ, si dhe bazuar në qarkoren buxhetore me numër 2025/02 të lëshuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) pika 3 kufijtë buxhetor për komunat thekson se në kolonën rezerva komunat duhet të ndajnë buxhet për shlyerjen e detyrimeve kontingjente mjetet për ndarjen për detyrime kontingjente duhet i marrin brenda kufijve të ndare buxhete për komunat me këtë qarkore duke përjashtuar nga kategoria e shpenzimeve paga dhe shtesa. Gjithashtu, sipas Rregullës Financiare nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, "Shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël". Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet t'i aplikojnë.

Gjatë vitit 2025, nga kategoria ekonomike investime kapitale përmes Thesarit, bazuar në vendime gjyqësore- përmbartimore për pagat jubilarë, shujta janë realizuar pagesa në vlerë totale prej 2,042,565€, borxhi kryesor 1,417,342€, shpenzimet përcjellëse përmbartimore 625,223€, nga investimet kapitale janë realizuar pagesa në vlerë 180,427€, për nga natyra i përkasin kategorisë mallra dhe shërbime. duke bërë keq klasifikim në kategoritë ekonomike që nuk përputhen me rregullat e kontabilitetit dhe menaxhimit financiar.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk kishte marrë parasysh kërkesat e Ligjit të buxheti dhe qarkores buxhetore për të bërë planifikim adekuat sipas nevojave dhe kërkesave të raportimit të shpenzimeve sipas kategorive përkatëse.

Ndikimi

Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, shpjen në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare të komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe si të tilla japin informata çorientuese për shfrytëzuesit e RVF-ve.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë që, janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që me rastin e përgatitjes së buxhetit të mirren parasysh kërkesat e Ligjit të buxhetit dhe qarkores buxhetore të lëshuara nga MFPT, në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit me qëllim të prezantimit të plotë dhe të saktë të tyre në pasqyra financiare vjetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Pagesë në kundërshtim me kontratën për shpenzimet e energjisë elektrike të stadiumit "Sami Kelmendi".

Gjetja

Neni 4, paragrafi 1 i Kontratës për dhënien në shfrytëzim të stadiumit "Sami Kelmendi", marrësi i tokës në shfrytëzim obligohet që stadiumin ta përdorë sipas qëllimit të përcaktuar në nenin 2 të kontratës, si dhe të kujdeset për mirëmbajtjen e tij dhe të mbulojë shpenzimet e energjisë elektrike, furnizimit me ujë, bartjes së mbeturinave dhe shpenzimet tjera që lidhen me paluajtshmërinë.

Komuna kishte lidhur kontratë me datën 01.09.2018 me Klubin e Futbollit për dhënien në shfrytëzim të stadiumit të futbollit "Sami Kelmendi" për periudhën 2018-2033. Sipas kushteve kontraktuale, shfrytëzuesi i stadiumit obligohet të mbulojë të gjitha shpenzimet operative, përfshirë shpenzimet e energjisë elektrike dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me funksionimin e objektit.

Megjithatë, me datën 02.10.2025, Kryetari i Komunës kishte marrë vendim për pagesën e shumës prej 7,000€ për mbulimin e një pjese të borxhit total të klubit e cila ishte në vlerë prej 19,959€, ndonëse ky obligim financiar, sipas kontratës, i takon shfrytëzuesit të stadiumit dhe jo Komunës.

Pagesa është kryer jo në përputhje me kontratën për shkak të vështirësive financiare të shfrytëzuesit të stadiumit, i cili nuk ishte në gjendje të përballonte detyrimet e tij kontraktuale për shpenzimet e energjisë elektrike.

Ndikimi

Pagesa e miratuar në kundërshtim me kontratën, shkakton rrezik të drejtpërdrejtë për dëmtimin e buxhetit komunal. Ky veprim krijon precedent për marrjen e obligimeve që nuk i takojnë Komunës dhe cenon parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, duke rrezikuar transparencën, llogaridhënien dhe përgjegjësinë në përdorimin e mjeteve publike.

Rekomandimi A1

Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që çdo vendim financiar i marrë nga Komuna të jetë në përputhje me kontratat dhe ligjin, duke përfshirë verifikimin paraprak financiar dhe juridik. Kryetari duhet të ndërmarrë masa konkrete për të parandaluar marrjen e obligimeve që mund të dëmtojnë buxhetin e Komunës dhe të garantojë transparencë, llogaridhënie dhe përgjegjësi në përdorimin e mjeteve publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Vonesa në pagesën e obligimeve

Gjetja

Neni 39.1 i LMFP-së parasheh se "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Në shtatë (7) mostra me rastin e vlerësimit të procedimit të faturave për pages në vlerë prej 9,119€, kemi identifikuar se komuna nuk kishte kryer pagesën e obligimeve brenda 30 ditësh nga periudha e përcaktuar ligjore. Vonesat në pagesën e faturave të obligimeve të papaguara ishin deri në 239 ditë pas përfundimit të afatit ligjor

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka pasur mjete të mjaftueshme financiare dhe ka hyrë në obligime pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë buxhetore.

Ndikimi

Vonesat në kryerjen e obligimeve mund t'i shkaktojnë kosto shtesë komunës për shkak se ajo mund të përballët me padi ku përveç vlerës së faturës duhet t'i paguaj kostot shtesë përfshirë kamatën, interesin dhe shpenzimet gjyqësore.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime të bëhet vetëm pas një analize të mirëfillte buxhetore, për të mundësuar pagesën e faturave ndaj kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mangësi në bazën e të dhënave të tatimpaguesve në pronë

Gjetja

Neni 12 i Ligjit nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, përcakton se komuna ka përgjegjësi për regjistrim dhe menaxhim të të dhënave të tatimit në pronë në regjistrat e tatimit në pronë ashtu siç përcaktohet në aktin nënligjor. Neni 3 i Ligjit nr.08/L-224 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, përcakton se për vendbanimin parësor deri në tridhjetë mijë (30,000) euro e para të pronës së vlerësuar të personit fizik i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit. Neni 7 i Udhëzimit Administrativ Nr.03/2011 për mbledhjen dhe regjistrimin e informatave mbi pronën dhe tatimpaguesin, paragrafi 1.1 specifikon "Të dhënat për tatimpaguesin përfshijnë numrin personal identifikues (tatimpaguesit fizik)".

Gjatë analizës së bazës së të dhënave të tatimit në pronë, sikurse edhe viteve të mëhershme kemi identifikuar 1,643 tatimpagues individual të cilët nuk kanë të prezantuar numrat personal në këtë bazë, prej tyre 1,182 kanë përfituar zbritjen për vendbanim parësor. Për më tepër, në gjashtë (6) raste zbritja është aplikuar dy (2) herë, dhe në një (1) rast zbritja është aplikuar tri (3) herë.

Po ashtu, sipas bazës së të dhënave që kemi pranuar kemi identifikuar se në total për 13,994 tatimpagues përfitues të zbritjes për vendbanim parësor, nuk është aplikuar zbritja prej 30,000€, por vetëm 15,000€.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së veprimeve të mjaftueshme lidhur me identifikimin dhe zgjidhjen e këtyre mangësive, nga ana e departamentit të tatimit në pronë komunal për të mundësuar aplikimin e saktë dhe të drejtë të zbritjeve për vendbanim parësor, si dhe mos azhurnimit të informatave për tatimpaguesit në bazën e të dhënave për tatimin në pronë.

- Ndikimi** Mungesa e të dhënave në data bazë për numrat identifikues personal të tatimpaguesve paraqet mangësi dhe potencialisht mund të ndikojë në përfitim të paligjshëm të disa hershëm të tatimpaguesve, të zbritjes së lejuar për vendbanim parësor. Poashtu, mos aplikimi i drejtë dhe saktë i vlerës së lejuar për zbritje të vendbanimit parësor ka ndikim tek mbivlerësimi i faturimit të tatimpaguesve.
- Rekomandimi B3** Kryetari duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve si dhe të sigurojë aplikim të saktë dhe drejtë të zbritjes së lejuar për vendbanim parësor. Përditësimi i të dhënave në Protax të bëhet në baza të rregullta periodike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mungesa e monitorimit të subvencioneve dhe pranimi i serrave nga komisioni pas përfundimit të kontratës

- Gjetja** Neni 4, paragrafi 2 i Marrëveshjes me përfituesit e serrave përcakton se Komuna mban të drejtën që brenda afatit trivjeçar nga nënshkrimi i marrëveshjes të bëjë monitorim, inspektim dhe auditim të realizimit të qëllimeve të subvencionit.
- Gjatë vitit 2025, Komuna kishte ndarë subvencione në sektorin e bujqësisë përmes projekteve të ndryshme për furnizim me pajisje dhe infrastrukturë bujqësore:
- Furnizim me serra 100 m², ku kishin përfituar 97 fermerë, në vlerë prej 107,767€;
 - Furnizim me serra 50 m², ku kishin përfituar 92 fermerë, në vlerë prej 53,820€;
 - Furnizim me 87 motokultivatorë, ku kishin përfituar 92 fermerë në vlerë prej 38,280€.

Megjithatë, ne kemi identifikuar se Komuna nuk kishte kryer monitorim pas dhënies së subvencioneve, edhe pse në marrëveshjet me fermerë ishte parashikuar një hap i tillë përgjatë 3 viteve pas dhënies së subvencioneve, hap ky i cili do të mundësonte verifikimin nëse përfituesit i kanë përdorur pajisjet dhe infrastrukturën e pranuar dhe nëse janë arritur objektivat e programit të subvencioneve.

Tutje, ne kemi identifikuar që në projektin "Furnizim me serra 100 m²", komisioni për pranimin e mallit ishte themeluar me 35 ditë vonesë. Vendimi për themelimin e komisionit ishte marrë me datë 04.06.2025, përderisa kontrata, punët kishin përfunduar me datë 30.04.2025.

Kjo situatë ka ndodhur si rezultat i mungesës së mekanizmave të brendshëm për monitorimin dhe vlerësimin e projekteve të subvencioneve pas realizimit të tyre, si dhe për shkak të moszbatimit të plotë të procedurave administrative lidhur me pranimin e mallit. Gjithashtu, mungesa e koordinimit dhe informimit në kohë për ndryshimet në rregullat e prokurimit publik ka ndikuar që komisioni për pranimin e mallit të mos formohet në kohën e duhur.

Ndikimi Mungesa e raporteve të monitorimit dhe vlerësimit pas realizimit të subvencioneve ul nivelin e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe nuk mundëson vlerësimin nëse subvencionet e dhëna kanë arritur objektivat e programit për zhvillimin e bujqësisë. Po ashtu, formimi i komisionit për pranimin e serrave pas përfundimit të punimeve paraqet mosrespektim të procedurave administrative të pranimit të mallit, duke dobësuar kontrollin formal mbi verifikimin e realizimit të projektit sipas kontratës dhe specifikimeve teknike.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë që të vendosen mekanizma të rregullt monitorimi për projektet e subvencioneve në bujqësi, si dhe të sigurojë që komisionet për pranimin e mallrave të themelohen me kohë dhe para përfundimit të punimeve, në përputhje me procedurat dhe planin dinamik të projektit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Pranimi i mallrave në kundërshtim me rregulloren e pasurisë

Gjetja Neni 8, Pranimi i pasurisë jo financiare i Rregullores MF- nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizata buxhetore, paragrafi 5 përcakton që Komisioni për Pranimin e Pasurisë jo Financiare duhet të jetë në përbërje jo më pak se tre (3) anëtar nga ekspertë të fushës përkatëse, duke përfshirë edhe zyrtarin me përgjegjësi materiale. Anëtar të këtij komisioni në rast nevojë mund të jenë edhe ekspertë të jashtëm.

Komuna kishte lidhur marrëveshje kornizë - Furnizimi me inventar i shkollës së mesme Ulpiana - Lipjan në vlerë prej 44,740€. Me datë 23.06.2025 Kryetari kishte marrë vendim për formimin e Komisionit për pranimin e pasurisë jo financiare prej dy (2) anëtarëve të komisionit, Kryetari i komisioni dhe një anëtar kjo në kundërshtim me rregulloren për menaxhimin e pasurisë e cila përcakton që Komisioni për pranimin e pasurisë duhet të jetë më së paku 3 anëtarë.

Kjo ka ndodhur për shkak se Kryetar i Komunës nuk kishte marrë parasysh kërkesat e rregullores me rastin e nxjerrjes së vendimit për formimin e komisioneve për pranim të pasurisë.

Ndikimi Pranimi i mallrave dhe furnizimeve në mungesë të komisionit të plotë të pranimit të mallrave rrit rrezikun se mallrat apo furnizimet mund të mos pranohen sipas cilësisë, kushteve dhe elementeve tjera të përcaktuara në kontratë.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë së për çdo furnizim të mallrave, pajisjeve të cilat komuna i blen apo i përvetëson duhet të themeloj komision konform kornizës ligjore në mënyrë që të ofrohet siguri se furnizimet e pranuar janë konformë kushteve të kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mos harmonizimi i regjistrave të pasurive me raportin e inventarizimit**Gjetja**

Sipas nenit 18.1 të Rregullores - nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, "Inventarizimi bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare". Gjithashtu sipas nenit 24 të po të njëjtës rregullore "Pas barazimit të gjendjes me inventarizim dhe vlerësim me gjendjen e regjistrave të pasurisë jo financiare, gjendja e pasurisë jo financiare duhet të jetë pjesë e pasqyrave vjetore financiare në pajtim me rregullën financiare për pasqyrat vjetore financiare".

Komisioni për inventarizimin e pasurisë jo financiarë të Komunës së Lipjanit ishte emëruar më 24.12.2025. Gjatë inventarizimit komisioni kishte identifikuar mangësi të shumta në menaxhimin e pasurisë, si pasuri të paregjistruara, të dëmtuara, pa barkod dhe të humbura, si dhe kishte evidentuar se 75 zyrtarë ende figuronin në regjistrin e pasurive pavarësisht se kishin lënë punën ose ishin pensionuar, përfshirë edhe mosdorëzimin e laptopëve nga ish-kuvendarët.

Edhe pse komisioni kishte përpiluar raportin e inventarizimit, nuk kishte dëshmi për trajtimin e diferencave apo përditësimin e regjistrit. Gjendje e njëjtë kishte figuruar edhe gjatë vitit 2024. Edhe pse komisioni kishte përpiluar raportin e inventarizimit, nuk kemi gjetur dëshmi se diferencat e identifikuar janë analizuar apo trajtuar përmes vendimeve konkrete nga menaxhmenti. Për më tepër, nuk kishte evidencë për iniciimin e procedurave lidhur me pasuritë e munguara apo për përditësimin e regjistrit të pasurive

Për më tepër, ne kemi kryer edhe ekzaminimin fizik të blerjeve të vitit 2025 si: furnizim me pajisje elektro shtëpiake në vlerë prej 9,468€ dhe furnizim me mobilje në vlerë prej 44,740€ ku kemi evidentuar se edhe pasuritë e blera, nuk ishin të pajisura me barkode.

Pas diskutimit me zyrtarët përgjegjës janë ndërmarre hapa drejt konsolidimit të regjistrit dhe shkarkimit të zyrtarëve të ngarkuar me pasuri nga regjistri, ku sipas përgjigjes nga zyrtari i pasurisë 43 zyrtarë është bërë korigjimi dhe ishin shkarkuar nga pasuria, përderisa 28 të tjerë ende figurojnë të ngarkuar me pasuri të cilët nuk e kanë bërë pranim dprëzimin e pasurisë me rastin e përfundimit të mardhënies së punës me komunën.

Mangësitë e evidentuara janë shkaktuar nga mos funksionimi i kontrolleve si dhe mungesën e llogaridhënies nga zyrtaret përgjegjës nëpër insitucionet përkatëse si dhe nga moszbatimi i rregullave për dorëzimin e pasurive nga ish-punonjësit dhe ish-kuvendarët.

Ndikimi

Këto parregullsia rrisin rrezikun për humbje ose keq administrim të pasurive dhe çojnë në pasaktësi në evidencat e komunës dhe cenojnë parimet e transparencës, llogaridhënies dhe menaxhimit të shëndoshë financiar.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë regjistrimin e saktë dhe përditësimin e pasurive të komunës, dorëzimin e tyre nga ish-punonjësit dhe ish-kuvendarët, monitorimin periodik për të parandaluar humbjet dhe keq administrimin, si dhe evidentimin e pasurive jashtë përdorimit, të transferuara ose të

dhuruara, duke garantuar transparencë, llogaridhënie dhe menaxhim të shëndoshë financiar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe shtesa ishte 13,827,622€, prej tyre ishin shpenzuar 13,822,175€ apo 98%. Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar ishte më i lart për 1,048,403€. Ekzekutimi i pagesave sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore ishte në vlerë prej 4,995€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 1355 ndërsa në fund të vitit 2025 numri i tyre ishte 1348.

Çështja C1 - Mos harmonizimi i kontratave të punës/akt emërimeve sipas kërkesave ligjore

Gjetja

Neni 102 i Ligjit nr.08/L-197 për Zyrarët Publik, paragrafi 1 parasheh “Me hyrje në fuqi të këtij ligji, obligohen të gjitha institucionet që të përgatisin dhe t’ju ofrojnë zyrtarëve/ëve aktual për nënshkrim aktet e reja të emërimit dhe/apo kontratat e punës” dhe paragrafi 2 “Aktet e emërimit dhe/apo kontratat e punës nënshkruhen nga të gjitha palët dhe duhet të jenë në harmoni me përcaktimet e këtij ligji, Ligjit të Punës, si dhe Ligjit për Paga në sektorin publik”. Neni 103 i këtij ligji, paragrafi 1 parasheh “Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, nxirren në afat prej një (1) viti nga hyrja në fuqi”. Neni 16 i Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, paragrafi 2 specifikon “Paga bazë për nëpunësit e shërbimit publik përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit që përket pozita e punës e përcaktuar në shtojcat e këtij ligji”.

Nga testimi i 70 mostrave, në 13 raste u identifikua se kontratat e punës ose aktet e emërimeve të nëpunësve/zyrtarëve komunal në sektorin e arsimit nuk ishin përditësuar për të reflektuar nivelin aktual të pagës bazë dhe koeficientin përkatës.

Edhe pse paga e këtyre punonjësve ishte përllogaritur sipas ligjit për pagat, mungesa e harmonizimit të kontratave ose akteve të emërimit me këtë nivel pagash përbën një mungesë në dokumentacionin zyrtar dhe në përcaktimin formal të të drejtave të punonjësve.

Vlen të përmendet, që gjatë auditimit Drejtoria e Arsimit ju është drejtuar me email drejtorëve të shkollave me kërkesën për nënshkrimin e kontratave të reja.

Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e dobësive të kontrollit të brendshëm tek burimet njerëzore në drejtorinë e arsimit për t’i harmonizuar kontratat me ligjet e reja.

Ndikimi

Kjo situatë ndikon në mos respektimin e kërkesave ligjore dhe krijon paqartësi, pasi që kontrata e punës/akt emërimi nuk paraqet nivelin e saktë të pagës bazë-koeficientit.

Rekomandimi C1

Kryetari duhet të siguroj se kontratat e punës/akt emërimet për nëpunësit/zyrtarët komunal përditësohen dhe harmonizohen sipas kornizës dhe afateve ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,682,750€. Kjo rritje vjen si rezultat i bartjes së të hyrave vetjake të pa shpenzuar nga vitin 2024 për 1,238,089€, rritje nga donacionet për 444,661€ prej tyre ishin shpenzuar 7,085,887€ apo 84%. Shpenzimi nga kjo kategori ndër tjerash kanë të bëjë me pagesat e bëra për projektet kapitale si për ndërtimin e rrugëve lokale, rregullimin e ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtimin e objekteve, fushave sportive, etj. Nga kategoria investime kapitale pagesa me vendime gjyqësorë janë 1,674,889€ apo 24% e totalit të shpenzimeve, të cilat kanë të bëjnë me për pagat jubilarë, shujtat dhe shpronësimet.

Çështja A4 - Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara dhe mos aplikim i penaleve

Gjetja

Rregulla nr. 01/2022 për prokurim publik taksativisht në neni 70.23 pika b parashihet se menaxheri i kontratës duhet të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Në kontratat publike të nënshkruara mes komunës dhe kontraktuesëve, përcaktohen kushtet e veçanta kontraktuale si dhe afati kohor për realizimin e projektit. Menaxherët e kontratave duhet të monitorojnë dhe të sigurojnë se kontratat po realizohen si duhet dhe në afatin e përcaktuar.

Në kontratat e nënshkruara ndërmjet Komunës dhe operatorëve ekonomik, përcaktohet afati kohor për realizimin e punimeve.

Në dy (2) raste, kemi vërejtur që punimet nuk ishin realizuar sipas planit dinamik siç parashihej me kontratë:

- Kontrata "Furnizimi dhe vendosja me bari sintetik dhe infrastruktura tjera ne fushat sportive ne Magure dhe Dobraje e madhe ", segmenti i dytë -faza e dytë", në vlerë 1,198,386€ ishte nënshkruar me datë 07.06.2024. Sipas kontratës data e fillimit të punëve ishte menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, dhe përfundimi për 200 ditë pune të ndara në dy vite fiskale maksimalisht deri më 31.03.2025 përkundër disa vonesave të arsyetuara nga menaxheri i projektit dhe organi mbikqyrës është bërë amandamentimi i kontratës për afate kohore dy herë. Vlera e punëve të realizuara deri me 20.08.2025 ishte 1,066,534€, apo 89% e vlerës së kontratës bazë dhe aneksit.
- Kontrata "Ndërtimi i nënkalimit, vazhdimi i ndërtimit të sheshit, ndërtimi i parkut qendror të aktivitetit dhe parkingut nëntokësor" në vlerë 6,127,777€, e nënshkruar më datë 19.09.2023. Sipas kontratës data e fillimit të punëve ishte menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, dhe përfundimi për 300 ditë pune të ndara në tri vite fiskale maksimalisht deri më 15.08.2025. edhe përkundër disa vonesave të arsyetuara nga menaxheri i projektit dhe organit mbikqyrës është bërë amandamentimi i kontratës për afate kohore dy herë Vlera e punëve të realizuara deri me 31.12. 2025, ishte 5,820,921€, apo 96% e vlerës së kontratës bazë.

Pra në dy projektet janë vërejtur vonesa në kryerjen e punëve sipas planit dinamik të paraparë me kontratë për të cilat komuna nuk kishte aplikuar ndonjë masë ndëshkuese ndaj OE për vonesat e evidentuara.

Arsyet apo shkaqet e vonesave ishin mungesa e një analize të mirëfilltë

para inicimit të projekteve kapitale, si dhe kohën e parashikuar për realizimin e këtyre projekteve, por edhe dobësitë në hartim të projekteve, ku gjatë realizimit të punëve është vërejtur mospërshtatje me gjendjen e terrenit.

Ndikimi

Vonesat në përfundimin e projekteve ndikojnë që komuna të mos arrijë objektivat e përcaktuara në vitin aktual dhe njëherësh mund të shkaktojnë vështirësi buxhetore për vitet pasuese. Mos aplikimi i penaleve për vonesat e shkaktuara paraqet devijim nga kërkesat ligjore dhe kushtet e kontratës.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në këtë fushë me një mbikëqyrje rigoroze në menaxhimin e kontratave. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuar, të aplikohen masat/ndëshkimet e parapara në kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike si psh: mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja B5 - Menaxhimi i kontratave jo përmes platformës së prokurimit

Gjetja

Rregullorja nr.001/2022 për Prokurim Publik, nenit 70.2 përcakton që:
 "Vlerësimi i përformancës së kontraktuesve do të bëhet: i) në sistem të prokurimit elektronik nëpërmjet modulit për vlerësim të përformancës së kontraktuesve; ii) nga menaxherët e kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, dhe iii) në pajtim me manualin për përdorim të modulit për vlerësim të përformancës së kontraktuesve". Mëtej, sipas nenit 70.24: "Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modul të përdorur për menaxhim të kontratës në sistemin e prokurimit elektronik."

Në 16 raste* menaxherët e kontratave/projekteve nuk e kanë mbajtur menaxhimin e kontratave përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.

Kjo ka ndodhur si rezultat i dështimeve të menaxherëve të kontratave për t'i menaxhuar kontratat përmes sistemit të prokurimit.

Ndikimi

Mosmenaxhimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikojë në një menaxhim jo efektiv të kontratave si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të marrë informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për të siguruar që menaxhimi i kontratave do të bëhet përmes platformës e-prokurimi në procesin e menaxhimit të kontratave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 148,468,583€, pasurive jokatitale është 511,280€, si dhe e stokeve 157,554€.

Çështja B6 - Mbivlerësim i pasurive

Gjetja

Neni 11 i Rregullores MF-nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore parasheh "Pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim. Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësim".

Bazuar në mostrat e testuara, kemi identifikuar se për tre objekte arsimore, ndonëse ndërtimet kishin përfunduar në vitin 2015 dhe shkollat janë funksionale dhe në përdorim, ende vazhdojnë të figurojnë në regjistra si investime në vijim, kjo për shkak të mungesës së pranimi teknik.

- Objekti arsimor në Kraishtë - bashkëfinancim me MAPL/MASHT, në vlerë 285,442€, vit i ndërtimit 2015. Nuk ishte amortizuar, duke rezultuar në mbivlerësim prej 71,360€ për periudhën 2015-2025.
- Objekti arsimor në Bujan - bashkëfinancim me MASHT, në vlerë 350,000€, vit i ndërtimit 2015. Nuk ishte amortizuar, duke rezultuar në mbivlerësim prej 87,500€ për periudhën 2015-2025.
- Objekti arsimor në Banull - bashkëfinancim me MASHT, vlerë 309,142€, vit i ndërtimit 2015. Nuk ishte amortizuar, duke rezultuar në mbivlerësim prej 77,286€ për periudhën 2015-2025.

Si pasojë, mbivlerësimi total i pasurive për shkak të mos-amortizimit arrin rreth 236,145€, duke krijuar një pasqyrë kontabël që nuk reflekton gjendjen reale të pasurive. Të tri (3) shkollat janë funksionale dhe në përdorim, por mungesa e pranimi teknik ka penguar amortizimin dhe ka bërë që ato të vazhdojnë të figurojnë si pasuri jashtë përdorimit.

Komuna e Lipjanit nuk ka mundur të përfundojë regjistrimin dhe amortizimin e objekteve arsimore në Kraishtë, Bujan dhe Banull, për shkak se MASHT nuk ka ofruar dokumentacionin përfundimtar dhe nuk ka bashkëpunuar për pranimin teknik të shkollave, edhe pse ndërtimet e shkollave ishin përfunduar në vitin 2015.

Ndikimi

Pasuria e mbajtur si investim në vijim nuk e pasqyron gjendjen e saktë të pasurive dhe ndikon në mbivlerësim të vlerës së pasurive.

Rekomandimi B6

Kryetari i komunës duhet të shqyrtojë mundësinë për një çështje të përsëritur, që daton nga viti 2015 të themelimit të një komisioni për të trajtuar të gjitha objektet arsimore të financuara nga Ministria dhe të cilat i kanë plotësuar kushtet për dorëzim-bartje të pronësisë të Komuna. Po ashtu, në bashkëpunim me Thesarin, regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim të kalojë në regjistrat e Komunës në mënyrë që të bëhet amortizimi dhe prezantimi i drejt i vlerës së pasurive në RVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2025 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë totale prej 6,559,600€. Kjo vlerë përbëhet nga të arkëtueshmet e tatimit në pronë në vlerë 6,460,826€, të arkëtueshmet nga qiratë në vlerë 68,514€ si dhe të arkëtueshmet nga shpronësimi i tokës komunale në vlerë 30,260€.

Çështja B7 - Rritja e llogarive të arkëtueshme dhe mungesë e veprimeve të mjaftueshme për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Neni 26 i ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, përcakton se "Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbarese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) eurove". Poashtu edhe ligji nr. 08/L-244 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.06/L-055 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 6 specifikon se për vitin tatimor 2024 dhe vitet tatimore pasuese, detyrimi tatimor për personat jo-rezidentë mund të paguhet në një kësht të vetëm, më së largu në datën 30 shtator të vitit tatimor përkatës.

Rregulla financiare 03/2010 për të hyrat, përcakton kërkesat dhe procedurat për regjistrimin, barazimin dhe mbledhjen e të hyrave vetanake.

Gjatë testimit të 39 mostrave për llogaritë e arkëtueshme, kemi identifikuar se në 14 raste të faturave të papaguara për tatimin në pronë në vlerë 47,727€, si dhe nëntë (9) raste të faturave të papaguara në vlerë 45,756€ për qiratë-pronat komunale, komuna nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe të mjaftueshme për inkasim të llogarive të arkëtueshme, përkundër faktit se këto llogari janë bartur ndër vite. Poashtu, në krahasim me vitin paraprak, LI/A në vitin 2025 janë rritur për 784,778€ apo 14%.

Rritja e llogarive të arkëtueshme është si rrjedhojë e mungesës së kontrolleve të brendshme të mjaftueshme, mungesës së veprimeve të nevojshme dhe mjaftueshme në drejtim të inkasimit të LI/A, poashtu mungesës së strategjisë për inkasim.

Ndikimi

Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin e komunës dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve komunale.

Rekomandimi B7

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrollit të brendshëm për menaxhimin e të arkëtueshmeve, si dhe rritjen e efikasitetit për arkëtimin e tyre. Poashtu të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve si dhe të krijojnë strategji të mbledhjes së tyre, përfshirë dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme ligjore për inkasim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmblendhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmblendhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁶	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	24,897,038	27,782,955	26,189,799	24,821,076	22,586,465
Grante Qeveritare - Buxheti	21,722,991	22,771,394	22,197,053	20,535,082	18,230,763
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,389,651	1,320,444	1,737,191	862,499
Të hyrat vetanake	3,174,047	3,174,047	2,344,405	2,387,776	2,224,126
Donacionet vendore	0	757	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	447,105	327,898	161,027	1,269,077

Buxheti final ishte 27,782,955€ në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,885.917€. Kjo rritje është rezultat i bartjes së të hyrave vetanake nga viti paraprak prej 1,389,651€, Vendimeve të Qeverisë në vlerë 1,048,403€ si dhe donacioneve prej 447,861€.

Komuna për vitin 2025 ka realizuar pagesa në vlerë 26,189,799€ apo 94% të buxhetit final. I ose 26,189,799€.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	24,897,038	27,782,955	26,189,799	24,821,076	22,586,465
Pagat dhe mëditjet	12,779,219	13,827,622	13,822,175	12,618,742	11,333,932
Mallrat dhe shërbimet	3,761,000	3,861,834	3,678,506	3,553,161	2,990,997
Komunalitë	450,000	450,684	441,061	412,179	379,853
Subvencionet dhe transferet	1,120,000	1,173,246	1,162,171	1,025,733	965,965
Investimet Kapitale	6,786,819	8,469,569	7,085,887	7,211,261	6,915,717

Shpjegimet për ndryshimet e buxhetit në kategoritë ekonomik janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 13,827,622€ rritur për 1,048,403€, krahasuar me buxhetin fillestar si rezultat i vendimeve të Qeverisë. Realizimi i buxhetit ishte në vlerë 13,822,175€ apo mbi 99% e buxhetit final.


Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte 3,861,834€ ishte rritur në krahasim me buxhetin fillestar për 100,834€. Kjo rritje vjen si rritje nga të hyrat vetanake të pa shpenzuara nga viti 2024, për 97,633€, si dhe rritje nga donacionet për 3,202€. Shpenzimi nga kjo kategori ndër tjerash kanë të bëjë me pagesat e bëra për furnizime, pajisje të teknologjisë informative, mirëmbajtje dhe servisim, pastrim të objekteve. Thesari nga kjo kategori sipas vendimeve përmbarimore/gjyqësore kishte paguar 683,203€. Realizimi i buxhetit ishte 3,678,506€ apo 95% e buxhetit final.

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,173,246€ ishte rritur në krahasim me buxhetin fillestar për 53,246€, nga të hyrat vetjake të paspenzuara nga viti 2024. Shpenzimet kanë të bëjnë me pagesat e bëra për përkrahjen e OJQ-ve, të individëve si dhe me shpenzimet e bëra nga thesari sipas vendimeve përmbarimore/gjyqësore për investime kapitale në vlerë prej 24,526€. Realizimi i buxhetit ishte 1,162,171€ apo mbi 99% e buxhetit final.

Buxheti final për shpenzime kapitale ishte 8,469,569€ krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,682,750€. Kjo rritje vjen si rezultat i bartjes së të hyrave vetjake të pa shpenzuar nga vitin 2024 për 1,238,089€, rritje nga donacionet për 444,661€.

Shpenzimi nga kjo kategori ndër tjerash ka të bëjë me pagesat e bëra për projektet kapitale si për ndërtimin e rrugëve lokale, rregullimin e ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtimin e objekteve, fushave sportive. Vlen të ceket se thesari nga kjo kategori sipas vendimeve përmbarimore/gjyqësore kishte paguar 1,674,889€. Realizimi i buxhetit ishte 7,085,887€ apo 84% e buxhetit final. Buxheti për investime kapitale nga fondi burimor granti qeveritar ishte shpenzuar në vlerë 4,851,660€ apo 91% ndërsa nga fondi burimor të hyrat vetanake të vitit 2025 ishte shpenzuar në vlerë 734,559€ apo 49% nga ky burim i financimit nuk kishte performancë të mirë buxhetore.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e realizuara në vitin 2025 ishin në vlerë 3,378,828€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

Po ashtu, komuna për vitin 2025, ka pranuar të hyra jotatimore nga gjobat nga trafiku, gjobat e gjykatës, gjobat e agjensionit të pyjeve në vlerë totale prej 538,121. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës. Komunës i alokohen për shpenzim.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	3,174,047	3,174,047	3,379,675	3,123,844	3,176,753
Të hyrat tatimore	1,444,973	1,444,973	1,399,129	1,360,881	1,461,266
Të hyrat jo tatimore	1,729,074	1,729,074	1,979,699	1,762,963	1,715,487
Të hyrat tjera	0	0	847		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024, kishte rezultuar me 15 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë gjashtë (6) rekomandime ishin zbatuar, shtatë (7) rekomandime nuk ishin zbatuar ende një (1) rekomandim ishte zbatuar pjesërisht si dhe një (1) rekomandim nuk është i aplikueshëm, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Edhe gjatë vitit 2025 Komuna e Lipjanit kishte pasur pagesa për vendime gjyqësore në kategori jo adekuate ekonomike.	Nuk ka filluar zbatimin

2.	Baza për opinion	Kryetari në bashkëpunim me Thesar të sigurojë korrigjimin e dyfishimit të pasurive në mënyrë që ato ta prezantojnë gjendjen e saktë.	Komuna e Lipjanit kishte ndërmarrë veprime dhe kishte arritur që të fshijë nga regjistri i pasurisë. Megjithatë, në gjatë vitit 2025 kemi identifikuar në regjister 3 shkolla të cilat kishin përfunduar në vitin 2015 por që në mungesë të pranimit teknik nuk ishin amortizuar. Megjithatë, shkollat ishin funksionale.	Nuk ka filluar zbatim
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se menaxhimi i kontratës nga menaxheri i projektit bëhet në pajtim me kërkesat ligjore, në mënyrë që kontrata publike kornizë me çmim njësi të realizohet në pajtueshmëri të plotë me peshën e përcaktuara në dosjen e tenderit.	Nuk kemi hasur në raste të tilla gjatë vitit 2025.	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se zyra e prokurimit zbaton kontrollet e duhura dhe nuk do ta lëshoj dosjen e tenderit nëse në paramasën dhe paralogarinë specifikohet emri i prodhuesit.	Nuk kemi hasur në raste të tilla gjatë vitit 2025.	I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që zyra e prokurimit zbaton kontratën e duhur ashtu siç e parasheh rregullativa ligjore.		I zbatuar
6.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të shtoj kontrollet për të siguruar rritjen e përgjegjësisë tek njësitë kërkuese lidhur me përgatitjen e specifikave për kontratat për punë, si dhe të ndërmarrë veprime për të parandaluar rreziqet e pagesave të dyfishta për punë të njëjta lidhur me projektet kapitale.	Nuk kemi hasur ndonjë çështje.	I zbatuar
7.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se kërkesat për leje ndërtimore dhe legalizim shqyrtohen brenda afateve kohore ligjore dhe se kërkesat për leje mjedisore të bëhen nga vet aplikuesit.	Nuk kemi hasur në raste të tilla gjatë vitit 2025.	I zbatuar


8.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të siguroj se kontratat e punës/akt emërimit për nëpunësit/zyrtarët komunal përditësohen dhe harmonizohen sipas kornizës dhe afateve ligjore.	Drejtorja e shëndetësisë kishte ndërmarrë veprime për nënshkrimin e kontratave të reja, përderisa drejtorja e arsimit ende nuk kishte arritur të zbatojë rekomandimin.	Pjesërisht i zbatuar
9.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari të sigurojë se të gjitha vendimet për emërim të drejtorëve evidentohen saktë përmes librit të protokollit komunal.	Gjatë vitit 2025 nuk kemi hasur të vendime të tilla.	I zbatuar
10.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që zyrtarët përgjegjës për monitorim dhe zbatim të projekteve të subvencionuara zbatojnë të gjitha procedurat ligjore me rastin e monitorimit dhe raportimit nga përfituesit.	Edhe gjatë vitit 2025 Komuna nuk kishte arritur që të bëjë monitorimin e subvencioneve.	Nuk ka filluar zbatimin
11.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë informata të sakta dhe fonde të mjaftueshme për kategorinë e pagave dhe shpronësimit dhe të adresojë këtë çështje tek Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, me qëllim të shmangies së shpenzimeve në emër të kamatave, tarifave të përbarimit dhe shpenzimeve tjera gjyqësore.	Rekomandim i mbyllur.	Nuk është i aplikueshëm më
12.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për të siguruar që menaxhimi i kontratave do të bëhet përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.	Edhe gjatë vitit aktual komuna nuk kishte arritur që të monitorojë kontratat përmes e-prokurimit.	Nuk ka filluar zbatimin
13.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve si dhe të sigurojë aplikim të saktë dhe drejtë të zbritjes së lejuar për vendbanim parësor. Përditësimi i të dhënave në Protax të bëhet në baza të rregullta periodike.	Nuk ka filluar zbatimin.	Nuk ka filluar zbatimin
14.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrollit të brendshëm për menaxhimin e të arkëtueshmeve, si dhe rritjen e efikasitetit për arkëtimin e tyre. Poashtu të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve si dhe të krijojë strategji të mbledhjes së tyre, përfshirë dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme ligjore për inkasim.	Nuk ka filluar zbatimin.	Nuk ka filluar zbatimin

15.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet financiare të jenë siguruar paraprakisht, dhe se faturat e kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimi të faturave.	Edhe në vitin 2025, për shkak të mungesës së fondeve kishte vonesa në kryerjen e obligimeve të papaguara.	Nuk ka filluar zbatimi
-----	-----------------------	--	---	------------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Neslihane Mati, Udhëheqëse e ekipit



Fidane Shala Haxhiu, Anëtare e ekipit



Fejzullah Fejza, Anëtar i ekipit



Besa Morina, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Lipjanit, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Imri Ahmeti

Kryetar i Komunës së Lipjanit

Data: 06.05.2026



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionit i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Furnizimi dhe montimi i serrave 100m² për fermerët e K. Lipjan-Ritenderim 122,000€; Furnizim me material hixhenik për IEA-të dhe institucionet komunale 74,830€; Mirëmbajtja dhe furnizimi me paisje të ndryshme për ngrohje qendrore në institucionet Edukativo Arsimore 80,000€ (vlëra e parashikuar); Furnizimi i qerdheve dhe kabinetëve në disa shkolla me tepison tepih për dysheme-ritenderim 150,000 € (vlëra e parashikuar); Furnizimi me material të ndryshëm për mirëmbajtjen e objekteve të institucioneve komunale.... (vlëra e parashikuar); Furnizimi i IEA me dru zjarri për periudhën tri vjeqare-Ritenderim 828,000€; Furnizimi me material të ndryshëm për nevojat e Komunës së Lipjanit-Ritenderim 175,000€; Furnizimi me mekanizëm bujqësor për fermer 190,000€; Mirëmbajtja e parqeve, parkingjeve dhe hapsirave tjera publike në qytetin e Lipjanit 279,700€; Hapja pastrimi i lumenjëve, Mirëmbajtja e varrezave dhe mirëmbajtja e hapsirave publike në territorin e Komunës së Lipjanit 550,000€ (vlëra e parashikuar); Hartimi i projekteve kryesore (detale) për infrastrukturën publike, ndërtimet mbi tokësore (vlëra e parashikuar); Ndërtimi i qendrës Multifunkionale në qytetin e Lipjanit - 2.626.262,00€; Asfaltimi i rrugës Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi Lumin Sitnica në Rufc të Ri - 469.207,00€; Llot 1 Ndërtimi i rrugicave në fshatrat Sillovi, Smallushë, Gumnasellë, Llugaxhi dhe Babush faza II-të - 468.190,00€; Asfaltimi i rrugicave në Magure, Vershec, Leletiq, Poturovc, Torinë, dhe Bujari Faza III - 686.180,00€; Rregullimi i oborrit të QKMF - 307.804,00€.
- ⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIKA OF KOSOVO

Komuna e Lipjanit
Zyra e Kryetarit



KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPJAN
LIPJAN MUNICIPALITY

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPJAN

DËRQUAR MË:
POSTATO DANA: 10.06.2026

MUNICIPA-
JEDINICA: 01-470/03-26/99

NR. KLASIFIKIMIT
BE PREDMETA PRILOG

Plani i zbatimit të rekomandimeve të auditorit të zyrës kombëtare të Auditimit për PVF të vitit 2025

Baza për Konkluzion	Të Gjeturat në Raportin e ZAP	Rekomandimet	Zyrtari përgjegjës për implementimin e rekomandimit	Aktivitetet e përcaktuara për implementimin e Rekomandimit	Afati kohor i përmes hjes
B1	Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve Gjatë vitit 2025, nga kategoria ekonomike investime kapitale përmes Thesarit, bazuar në vendime gjyqësore- përmbarimore për pagat jubilarë, shujta janë realizuar pagesa në vlerë totale prej 2,042,565€, borxhi kryesor 1,417,342€, shpenzimet përcjellëse përmbarimore 625,223€, nga investimet kapitale janë realizuar pagesa në vlerë 180,427€, për nga natyra i përkasin kategorisë mallra dhe shërbime. duke bërë keq klasifikim në kategoritë ekonomike që nuk përputhen përputhen me rregullat e kontabilitetit dhe menaxhimit financiar.	Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë që, janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që me rastin e përgatitjes së buxhetit të merren parasysh kërkesat e Ligjit të buxhetit dhe qarkores buxhetore të lëshuara nga MFTP, në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit me qëllim të prezantimit të plotë dhe të saktë të tyre në pasqyra financiare vjetore.	ZKF- ZKA	Ketë rekomandim edhe këtë vit nuk mund ta përmblushim, kjo nuk varet nga planifikimi i këtyre shpenzimeve me buxhetin e komunës	NA

✓

A1	Pagesë në kundërshtim me kontratën për shpenzimet e energjisë elektrike të stadiumit 'Sami Kelmendi' Komuna kishte lidhur kontratë me datën 01.09.2018 me Klubin e Futbollit për dhënie në shfrytëzim të stadiumit të futbollit "Sami Kelmendi" për periudhën 2018-2033. Sipas kushteve kontraktuale, shfrytëzuesi i stadiumit obligohet të mbulojë të gjitha shpenzimet operative, përfshirë shpenzimet e energjisë elektrike dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me funksionimin e objektit. Megjithatë, me datën 02.10.2025, Kryetari i Komunës kishte marrë vendim për pagesën e shumës prej 7,000€ për mbulimin e një pjese të borxhit total të klubit e cila ishte në vlerë prej 19,959€, ndonëse ky obligim financiar, sipas kontratës, i takon shfrytëzuesit të stadiumit dhe jo Komunës.	Rekomandimi A1 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që çdo vendim financiar i marrë nga Komuna të jetë në përputhje me kontratat dhe ligjin, duke përfshirë verifikimin paraprak financiar dhe juridik. Kryetari duhet të ndërmarrë masa konkrete për të parandaluar marrjen e obligimeve që mund të dëmtojnë buxhetin e Komunës dhe të garantojë transparencë, llogaridhënie dhe përgjegjësi në përdorimin e mjeteve publike.	Drejtori a e SHP	Ky shpenzim nuk do të përsëritet, sepse Komuna e ka kryer obligimin e borxheve të mbetura të komunës për periudhën para nënshkrimit të kontratës me KF	Rekomandimi mund të konsiderohet i realizuar
B2	Vonesa në pagesën e obligimeve Në shtatë (7) mostra me rastin e vlerësimit të procedimit të faturave për pagës në vlerë prej 9,119€, kemi identifikuar se komuna nuk kishte kryer pagesën e obligimeve brenda 30 ditësh nga periudha e përcaktuar ligjore. Vonesa në pagesën e faturave të obligimeve të papaguara ishin deri në 239 ditë pas përfundimit të afatit ligjor. Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka pasur mjete të mjaftueshme financiare dhe ka hyrë në obligime pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë buxhetore.	Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime të bëhet vetëm pas një analize të mirëfillte buxhetore, për të mundësuar pagesën e faturave ndaj kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturave.	ZKF - DBF	Ne do të kërkojmë nga çdo njësi buxhetore që para se të pranohen mallrat dhe shërbimet të sigurohen mjete dhe faturat të paguhen brenda afatit prej 30 ditëve, në raste kur mjete të zotuar merren nga thesari për pagesa të padive për shujta apo paga jubilarë kjo mund të ndikoj që ndonjë	Gjatë vitit 2026

W

				faturë të paguhet me vonesë	
B3	Mangësi në bazën e të dhënave të tatimpaguesve në pronë Gjatë analizës së bazës së të dhënave të tatimit në pronë, sikurse edhe viteve të mëhershme kemi identifikuar 1,643 tatimpagues individual të cilët nuk kanë të prezantuar numrat personal në këtë bazë, prej tyre 1,182 kanë përfutur zbritjen për vendbanim parësor. Për më tepër, në gjashtë (6) raste zbritja është aplikuar dy (2) herë, dhe në një (1) rast zbritja është aplikuar tri (3) herë. Po ashtu, sipas bazës së të dhënave që kemi pranuar kemi identifikuar se në total për 13,994 tatimpagues përfutur të zbritjes për vendbanim parësor, nuk është aplikuar zbritja prej 30,000€, por vetëm 15,000€.	Rekomandimi B3 Kryetari duhet të ndërmer veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve si dhe të sigurojë aplikim të saktë dhe drejtë të zbritjes së lejuar për vendbanim parësor. Përditësimi i të dhënave në Protax të bëhet në baza të rregullta periodike.	Sektori i Tatimit ne pronë -DBF	Sektori i tatimit ne prone giate vitit 2025 dhe po ashtu edhe giatë këtij viti po përballet me probleme te mos funksionimit te programit por tax i cili menaxhohet nga DTP pran MFT , dhe gjithashtu po paraqiten gabime ne faturat e obliguesve tatimor , ky rekomandim duhet adresuar në DTP pran MFT	Gjatë vitit 2026
B4	Mungesa e monitorimit të subvencioneve dhe pranimit i serrave nga komisioni pas përfundimit të kontratës Gjatë vitit 2025, Komuna kishte ndarë subvencione në sektorin e bujqësisë përmes projekteve të ndryshme për furnizim me pajisje dhe infrastrukturë bujqësore: Furnizim me serra 100 m², ku kishin përfutur 97 fermerë, në vlerë prej 107,767€; Furnizim me serra 50 m², ku kishin përfutur 92 fermerë, në vlerë prej 53,820€; Furnizim me 87 moto kultivatorë, ku kishin përfutur 92 fermerë në vlerë prej 38,280€.	Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë që të vendosen mekanizma të rregullt monitorimi për projektet e subvencioneve në bujqësi, si dhe të sigurojë që komisionet për pranimitin e mallrave të themelohen me kohë dhe para përfundimit të punimeve, në përputhje me procedurat dhe planin dinamik të projektit.	DBPZH R	Komuna ka formuar edhe ne vitet paraprake , dhe do të formoj komisione për monitorimin e mekanizmit të dhënë për fermerët lidhur me përdorimin e tyre sipas dhe arrijten e objektivave të programit brenda afatit 3 vjeçar	Shtator 2026

11

	Megjithatë, ne kemi identifikuar se Komuna nuk kishte kryer monitorim pas dhënies së subvencioneve, edhe pse në marrëveshjet me fermerë ishte parashikuar një hap i tillë përgjatë 3 viteve pas dhënies së subvencioneve, hap ky i cili do të mundësonte verifikimin nëse përfituesit i kanë përdorur pajisjet dhe infrastrukturën e pranuar dhe nëse janë arritur objektivat e programit të subvencioneve. Tufje, ne kemi identifikuar që në projektin "Furnizim me serra 100 m²", komisioni për pranimin e mallit ishte themeluar me 35 ditë vonësë. Vendimi për themelimin e komisionit ishte marrë me datë 04.06.2025, përderisa kontrata, punët kishin përfunduar me datë 30.04.2025.				
A2	Praimi i mallrave në kundërshtim me rregulloren e pasurisë Komuna kishte lidhur marrëveshje kornizë - Furnizimi me inventar i shkollës së mesme Ulpiana - Lipjan në vlerë prej 44,740€. Me datë 23.06.2025 Kryetari kishte marrë vendim për formimin e Komisionit për pranimin e pasurisë jo financiare prej dy (2) anëtarëve të komisionit, Kryetari i komisioni dhe një anëtar kjo në kundërshtim me rregulloren për menaxhimin e pasurisë e cila përcakton që Komisioni për pranimin e pasurisë duhet të jetë më së paku 3 anëtarë.	Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë së për çdo furnizim të mallrave, pajisjeve të cilat komuna i blen apo i përvetëson duhet të themeloj komision konform kornizës ligjore në mënyrë që të ofrohet siguri se furnizimet e pranuar janë kon formë kushteve të kontratës.	DKA	Ne jemi duke e zbatuar pranimin e mallrave me komision prej tre anëtarëve, në rastet kur mungon një anëtarë i emëruar i komisionit do të kërkohet të emërohet një anëtar i ri i komisionit	Prej Muajit Korrik 2026
A3	Mos harmonizimi i regjistrave të pasurive me raportin e inventarizimit Komisioni për inventarizimin e pasurisë jo financiarë të Komunës së Lipjanit ishte emëruar më 24.12.2025. Gjatë inventarizimit komisioni kishte identifikuar mangësi të shumta në menaxhimin e	Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë regjistrimin e saktë dhe përditësimin e pasurive të komunës, dorëzimin e tyre nga ish-punonjësit dhe ish-kuvendarët,	ZKA-ZKF, zyrtari i pasurive	Për çështjen e laptop eve të pa dorëzuar nga ish-anëtarët e Kuvendit Komunal, zyrtarja kompetente për shkarkimin e	Prej Muajit Qershor - Tetor 2026

	pasurisë, si pasuri të paregjistruara, të dëmtuara, pa barkod dhe të humbura, si dhe kishte evidentuar se 75 zyrtarë ende figuronin në regjistrin e pasurive pavarësisht se kishin lënë punën ose ishin pensionuar, përfshirë edhe mosdorëzimin e laptopëve nga ish-kuvendarët. Edhe pse komisioni kishte përpiluar raportin e inventarizimit, nuk kishte dëshmi për trajtimin e diferencave apo përditësimin e regjistrit. Gjendje e njëjtë kishte figuruar edhe gjatë vitit 2024. Edhe pse komisioni kishte përpiluar raportin e inventarizimit, nuk kemi gjetur dëshmi se diferencat e identifikuar janë analizuar apo trajtuar përmes vendimeve konkrete nga menaxhmenti. Për më tepër, nuk kishte evidencë për iniciimin e procedurave lidhur me pasuritë e munguara apo për përditësimin e regjistrit të pasurive	monitorimin periodik për të parandaluar humbjet dhe keq administrimin, si dhe evidentimin e pasurive jashtë përdorimit, të transferuara ose të dhuruara, duke garantuar transparencë, llogaridhënie dhe menaxhim të shëndoshë financiar.	pasurisë është në pritje të një vendimi nga Zyra e Kryetarit, i cili do të shërbejë si bazë për procedimin dhe përfundimin e procesit të shkarkimit të tyre nga evidencat e pasurisë, prandaj, vlerësojmë se janë ndërmarrë veprime konkrete për trajtimin e diferencave të identifikuara, harmonizimin e evidencave dhe përditësimin e regjistrave të pasurisë, në përputhje me kompetencat dhe dokumentacionin në dispozicion.	
C1	Mos harmonizimi i kontratave të punës/akt emërimeve sipas kërkesave ligjore Nga testimi i 70 mostrave, në 13 raste u identifikua se kontratat e punës ose aktet e emërimeve të nëpunësve/zyrtarëve komunal në sektorin e arsimit nuk ishin përditësuar për të reflektuar nivelin aktual të pagës bazë dhe koeficientin përkatës. Edhe pse paga e këtyre punonjësve ishte përlogaritur sipas ligjit për pagat, mungesa e harmonizimit të	Rekomandimi C1 Kryetari duhet të siguroj se kontratat e punës/akt emërimit për nëpunësit/zyrtarët komunal përditësohen dhe harmonizohen sipas kornizës dhe afateve ligjore.	DKA	DKA është duke punuar me të gjithë drejtorët e shkollave që nënshkruan kontratave sipas ligjit për punëtorët arsimor të përfundoj deri më 01.07.2026 Korrik 2026

M

A4	kontratave ose akteve të emërimit me këtë nivel pagash përbën një mungesë në dokumentacionin zyrtar dhe në përcaktimin formal të të drejtave të punonjësve. Vlen të përmendet, që gjatë auditimit Drejtoria e Arsimit ju është drejtuar me email drejtorëve të shkollave me kërkesën për nënshkrimin e kontratave të reja Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara dhe mos aplikim i penaleve Kontrata "Furnizimi dhe vendosja me bari sintetik dhe infrastruktura tjera ne fushat sportive ne Magurë dhe Dobrajë e madhe ", segmenti i dytë - faza e dytë", në vlerë 1,198,386€ ishte nënshkruar me datë 07.06.2024. Sipas kontratës data e fillimit të punëve ishte menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, dhe përfundimi për 200 ditë pune të ndara në dy vite fiskale maksimalisht deri më 31.03.2025 përkundër disa vonesave të arsyetuara nga menaxheri i projektit dhe organi mbikëqyrës është bërë amandamentimi i kontratës për afate kohore dy herë. Vlera e punëve të realizuara deri me 20.08.2025 ishte 1,066,534€, apo 89% e vlerës së kontratës bazë dhe aneksit. • Kontrata "Ndërtimi i nënkallimit, vazhdimi i ndërtimit të sheshit, ndërtimi i parkut qendror të aktivitetit dhe parkingut nëntokësor" në vlerë 6,127,777€, e nënshkruar më datë 19.09.2023. Sipas kontratës data e fillimit të punëve ishte menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, dhe përfundimi për 300 ditë pune të ndara në tri vite fiskale maksimalisht deri më 15.08.2025. edhe përkundër disa vonesave të arsyetuara nga menaxheri i projektit dhe organi mbikëqyrës është bërë amandamentimi i kontratës për afate kohore dy				
		Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në këtë fushë me një mbikëqyrje rigoroze në menaxhimin e kontratave. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat/ndëshkimet e parapara në kontratë.	Drejtori a për Infrastr ukturë	Ne rastet kur vonesat ne realizimin e projekteve rezultojnë nga problemet e pazgjidhura nga AK, ne nuk mund te zbatojmë penale ndaj OE, ndërsa ne rastet e vonesave për shkak të gabimeve në projektim ne do të marrim masa ligjore ndaj kompanisë projektuese	Nga Muaji Qershor 2026

h

B6	Mbivlerësim i pasurive Bazuar në mostrat e testuara, kemi identifikuar se për tre objekte arsimore, ndonëse ndërtimet kishin përfunduar në vitin 2015 dhe shkollat janë funksionale dhe në përdorim, ende vazhdojnë të figurojnë në regjistrat si investime në vijim, kjo për shkak të mungesës së pranimin teknik. Objekti arsimor në Kraishtë – bashkëfinancim me MAPL/MASHT, në vlerë 285,442€, vit i ndërtimit 2015. Nuk ishte amortizuar, duke rezultuar në mbivlerësim prej 71,360€ për periudhën 2015–2025. Objekti arsimor në Bujan – bashkëfinancim me MASHT, në vlerë 350,000€, vit i ndërtimit 2015. Nuk ishte amortizuar, duke rezultuar në mbivlerësim prej 87,500€ për periudhën 2015–2025. Objekti arsimor në Banull – bashkëfinancim me MASHT, vlerë 309,142€, vit i ndërtimit 2015. Nuk ishte amortizuar, duke rezultuar në mbivlerësim prej 77,286€ për periudhën 2015–2025. Si pasojë, mbivlerësimi total i pasurive për shkak të mos-amortizimit arrin rreth 236,145€, duke krijuar një pasqyrë kontabël që nuk reflekton gjendjen reale të pasurive. Të tri (3) shkollat janë funksionale dhe në përdorim, por mungesa e pranimin teknik ka penguar amortizimin dhe ka bërë që ato të vazhdojnë të figurojnë si pasuri jashtë përdorimit. Komuna e Lipjanit nuk ka mundur të përfundojë regjistrimin dhe amortizimin e objekteve arsimore në Kraishtë, Bujan dhe Banull, për shkak se MASHT nuk ka ofruar dokumentacionin përfundimtar dhe nuk ka bashkëpunuar për pranimin teknik të shkollave,	Rekomandimi B6 Kryetari i komunës duhet të shqyrtojë mundësinë për një vit 2015 të themelimit të një komisioni për të trajtuar të gjitha objektet arsimore të financuara nga Ministria dhe të cilat i kanë plotësuar kushtet për dorëzim-bartje të pronësisë të Komuna. Po ashtu, në bashkëpunim me Thesarin, regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim të kalojë në regjistrat e Komunës në mënyrë që të bëhet amortizimi dhe prezantimi i drejt i vlerës së pasurive në RVF.	ZKA-ZKF , zyrtari i pasurive	Që nga viti 2015, Komuna ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me zyrtarët kompetentë të Ministrisë së Arsimit lidhur me bashkëfinancimin e tri objekteve arsimore. Gjatë kësaj periudhe, në baza vjetore disa herë gjatë këtyre viteve kemi parashtruar kërkesa me shkrim dhe kemi zhvilluar takime zyrtare me qëllim të sigurimit dhe bartjes së dokumentacionit përkatës (CPO), i cili është i nevojshëm për regjistrimin dhe kapitalizimin e plotë të këtyre pasurive në evidencat e Komunës, në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi. Megjithatë, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme, deri më tani nuk kemi pranuar
----	--	--	--	---

Gjatë
vitit 2026

9

	herë Vlera e punëve të realizuara deri me 31.12.2025, ishte 5,820,921€, apo 96% e vlerës së kontratës bazë. Arsyet apo shkaqet e vonesave ishin mungesa e një analize të mirëfilltë para inicimit të projekteve kapitale, si dhe kohën e parashikuar për realizimin e këtyre projekteve, por edhe dobësitë në hartim të projekteve, ku gjatë realizimit të punëve është vërejtur mospërshtatje me gjendjen e terrenit.				
B5	Menaxhimi i kontratave jo përmes platformës së prokurimit Rregullorja nr.001/2022 për Prokurim Publik, neni 70.2 përcakton që: “Vlerësimi i performancës së kontraktuesve do të bëhet: i) në sistem të prokurimit elektronik nëpërmjet modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve; ii) nga menaxherët e kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, dhe iii) në pajtim me manualin për përdorim të modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve”. Mëtej, sipas nenit 70.24: “Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistemin e prokurimit elektronik.” Në 16 raste* menaxherët e kontratave/projekteve nuk e kanë mbajtur menaxhimin e kontratave përmes sistemit elektronik të prokurimit publik. Kjo ka ndodhur si rezultat i dështimeve të menaxherëve të kontratave për t'i menaxhuar kontratat përmes sistemit të prokurimit	Rekomandimi B5 Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për të siguruar që menaxhimi i kontratave do të bëhet përmes platformës E prokurimit në procesin e menaxhimit të kontratave.	Drejtori a e prokuri mit -DI, DKA, DSHMS , DA	Ne do të kërkojmë nga njësitë kërkuese që të plotësojnë PMK siç kërkohet me ligjin mbi prokurimin publik, dhe do të kërkojmë që menaxherët e kontratave që nuk kanë qasje në E prokurimit të sjellin në drejtorin e prokurimit PMK, kopjen fizike, synimi është të mbajmë një trajnim për të gjithë menaxherët e kontratave lidhur me publikimin e PMK në E prokurimi	Nga Muaji Korrik 2026

Ch

	edhe pse ndërtimet e shkollave ishin përfunduar në vitin 2015.			dokumentacionin e kërkuar dhe as përgjigje konkrete lidhur me këtë çështje. Për këtë arsye, gjatë vitit 2026 do t'i drejtohem përsëri Ministrisë së Arsimit me kërkesë zyrtare për sigurimin e dokumentacionit përkatës, me qëllim që Komuna të ketë mundësi t'i regjistrojë dhe kapitalizojë këto tri projekte në regjistrin e pasurive, në përputhje me obligimet ligjore dhe kërkesat e raportimit financiar.	
B7	Rritja e llogarive të arkëtueshme dhe mungesë e veprimeve të mjaftueshme për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme Gjatë testimit të 39 mostrave për llogaritë e arkëtueshme, kemi identifikuar se në 14 raste të faturave të paguara për tatimin në pronë në vlerë 47,727€, si dhe nëntë (9) raste të faturave të paguara në vlerë 45,756€ për qiratë-pronat komunale, komuna nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe të mjaftueshme për inkasim të	Rekomandimi B7 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrollit të brendshëm për menaxhimin e të arkëtueshmeve, si dhe rritjen e efikasitetit për arkëtimin e tyre. Po ashtu të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve si dhe të krijojë strategji të mbledhjes së tyre, përfshirë dhe	DBF - DEZH	ZTP ne vazhdimësi merret me sensibilizimin e qytetarëve për pagesën me kohë të tatimit në pronë, dërgon vërtetje për tatim paguesit e mëdhenjë dhe vërejtjet e fundit .	Gjatë vitit 2026

	llogarive të arkëtueshme, përkundër faktit se këto llogari janë bartur ndër vite. Po ashtu, në krahasim me vitin paraprak, L/A në vitin 2025 janë rritur për 784,778€ apo 14%. Rritja e llogarive të arkëtueshme është si rrjedhojë e mungesës së kontrolleve të brendshme të mjaftueshme, mungesës së veprimeve të nevojshme dhe mjaftueshme në drejtim të inkasimit të L/A, poashtu mungesës së strategjisë për inkasim.	ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme ligjore për arkëtimin e borxheve	Sa i përket Llogarive të arkëtueshme për qirat nga pronat komunale ne do ti propozojmë Asamblesë komunale fshirjen e borxheve të pa arkëtuara për vitet 2002-2008 , pasi që këto LLA janë parashikuar si borxhe
--	---	--	--

Data : 08.06.2026

Grupi punues

Miratol : Kryetari i Komunës

z. Imri Ahmeti

